

Nr. 25 prot

Dt. 28/12/2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

**VENDIM**

**Nr. 14, datë 24/12/2020**

**PËR**  
**MIRATIM E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR” PËR**  
**ENERGJI ELEKTRIKE SHOQËRISË “AFRIMI-K” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,nenit 41, nenit 50, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit 111/2012 datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”(i ndryshuar) dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozim të Z.A.B.U. Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V E N D O S I:**

1-Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor” për prodhim energjie elektrike, shoqërisë “AFRIMI-K” SH.P.K., (për H/C THANZA 2), për përdorim të burimit ujor Përroi i Leshnicës, degë e Lumit Drin, me vendndodhje në fshatin Kolsh, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

2-Ngarkohet Z.A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MAJLINDA ANGONI**

